**Shoqëria "Real Eco Energy" Sh.p.k.**
**NUIS: M11312037A**

**VENDIM I**

**ORTAKUT TË VETËM TË SHOQËRISË PËRTHITHËSE**

**datë 03/05/2023**

Sot më datë 03/05/2023, në selinë e shoqërisë "Real Eco Energy" shpk, mbahet mbledhja e Ortakut të Vetëm, z. Edi Agalliu, që zotëron 100% të kuotave të kapitalit.

I cili, pasi mori në shqyrtim ecurinë e deritanishme dhe nevojat e shoqërisë, bazuar në përcaktimet e Ligjit nr. 9901, datë 14.04.2008 "*Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare*" dhe në ato të Statutit të shoqërisë,

**VENDOSI:**

1. Të miratojnë në parim vendimin e riorganizimit, nëpërmjet bashkimit me përthithje të shoqërisë "AgroRoma 2019" Sh.p.k me NUIS L91325001D, me shoqërinë "Real Eco Energy" sh.p.k me NUIS M11312037A, duke transferuar aktivitetin e shoqërisë "Real Eco Energy" shpk (shoqëria e përthithur).

2. Të miratojë Marrëveshjen e riorganizimit të shoqërive nëpërmjet bashkimit me përthithje të mbajtur në Tiranë, në datë 13.01.2023 (dy mijë e njëzetë e tre), mes shoqërisë "AgroRoma 2019" në pozicionin e shoqërisë pritëse dhe "Real Eco Energy" shpk në pozicionin e shoqërisë që përthithet.

3. Të miratojë veprimin e transferimit të aktivitetit dhe të të gjitha aktiveve dhe pasiveve në shoqërinë pritëse "AgroRoma 2019" shpk (shoqëria përthithëse), kalim i cili është pranuar paraprakisht nga ana e shoqërisë "Real Eco Energy" shpk (shoqëria e përthithur), nëpërmjet nënshkrimit të Projekt Marrëveshjes së Transferimit të Aktivitetit të Biznesit dhe miratimit nga Ortaku i Vetëm i shoqërisë së përthithur.

4. Inventarët dhe Pasqyrat Financiare të Shoqërisë "Real eco Energy" sh.p.k. më datë 31 Dhjetor 2022, do të jenë baza mbi të cilën do të përllogariten aktivet dhe pasivet në përgjithësi të shoqërisë "Real Eco Energy" sh.p.k dhe për rrjedhojë edhe pjesët që do të kalojnë në shoqërinë pritëse përkatëse.

5. Të bëjë transferimin e aktivitetit në përputhje me dispozitat ligjore në fuqi.

**6.** Ortak i shoqërisë do të mbetet z. Igli Tare, me 100 % të kuotave të kapitalit.

**7.** Vlerësimin e Shoqërisë "Real Eco Energy" shpk. si e prishur dhe kryerjen e procedurave ligjore për çregjistrimin vullnetar të saj pranë Qendrës Kombëtare të Biznesit.

**8.** Ky vendim nënshkruhet dhe hyn në fuqi sot në datë 03/05/2023.

**ORTAKU I VETËM I SHOQËRISË**

**EDI AGALLIU**